



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt.	25.07.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-334

## KËSHILLI DREJTUES

Cruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 08.07.2022

Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në bazë të nenit 2, nenit 8 dhe dispozitave të pjesës V të Ligjit për Zyrtarët Publikë, dispozitave të Ligjit të Punës dhe në përputhje me nenin 17, paragrafi 1 dhe nenin 39 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke vendosur në lidhje me propozimin për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm me nr. prot. 01-279, të datës 23.06.2022, parashtruar nga Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, pas përfundimit të të gjitha procedurave për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit, sipas konkursit nr. 01-170, të datës 10.05.2022, në mbledhjen e mbajtur më 08.07.2022, me votim të fshehtë, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Nexhmedin Krasniqi zgjedhet në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, me mandat 4 vjeçar.
- II. Pas përfundimit të mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm z. Nexhmedin Krasniqi, i ruhet marrëdhënia e punës me Universitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi në pozitën sipas aktit të emërimit, plotësim - ndryshimit nr. 06-179, të datës 01.10.2018.
- III. Obligohet Rektori i Universitetit në cilësinë e punëdhënësit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pas përfundimit të mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm, të njëjtin ta sistemoj në një pozitë tjetër adekuate të punës, të nivelit drejtues, në pajtim me përgatitjen dhe aftësinë e tij profesionale.
- IV. Të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm specifikohen në kontratën e punës të nënshkruar nga Rektori pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Duke u bazuar në nenin 17, 39 dhe 40 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 14.02.2022, mori vendim mbi shpalljen e konkursit publik për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit (Vendimi me nr. prot. 01-76, i datës 01.03.2022). Konkursi publik me nr. prot. 01-170, për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, është shpallur më datë 10.05.2022, dhe i njëjti është publikuar në uebfaqen e Universitetit.

Rektori i Universitetit në mbështetje të nenit 39 të Statutit të Universitetit, nenit 68 paragrafi 7 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues me nr. prot. 01-76, të datës 01.03.2022, ka formuar Komisionin profesional për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas konkursit me nr. prot. 01-170, të datës 10.05.2022.

Në zbatim të vendimit me nr. prot. 01-216, të datës 20.05.2022 dhe duke u bazuar në Konkursin me nr. prot. 01-170 si dhe mbështetur në dispozitat ligjore përkatëse, Komisioni profesional e zhvilloi procesin e testimit dhe të intervistimit, njëkohësisht e dorëzoi raportin me nr. prot. 03-177, me rezultatet e kandidatëve sipas procedurës së rekrutimit në fjalë.

Bazuar në raportin me nr. prot. 03-177, të datës 13.06.2022, të Komisionit profesional për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Rektori i Universitetit të Prizrenit, duke u bazuar në nenin 39 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, i ka propozuar Këshillit Drejtues propozimin për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm sipas shkresës me nr. prot. 01-279, që kandidati me rezultatin më të mirë të arritur në këtë procedurë rekrutimi, z. Nexhmedin Krasniqi, të zgjedhet Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Bazuar në atë që u tha më lartë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 08.07.2022, pas zhvillimit të procesit të votimit të fshehtë, njëzëri vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Komisionin e Ankesave në nivel të Universitetit, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij vendimi.

**Vendimi i dërgohet:**

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- NJMBNJ;
- Zyrës së Financave;
- Zyrës Ligjore;
- Të përmendurit dhe
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrija

